



Bashkia Durrës, INARK – Instituti Nacional i Arkitekturës
**Konkursi internacional për Rivitalizimin e Sheshit Liria në Durrës/
*Revitalization Freedom square International Competition in Durres***

15 qershor – 31 dhjetor 2008

SHPLLJE NGA INICIATIVA Qyteti i Durrësit, maj 2008

Përgjegjës i konkursit:

Inxh. **Adrian Çela**, nënkryetari i Bashkisë Durrës

E – MAIL adrian.cela@durres.gov.al

për informacione: telefon 00355 2 224800, celular 00355 692049383

Sekretaria e konkursit:

Ina Xhakoni, Zyra Urbanistikës Bashkia Durrës

Konsulentet shkencor për përpilimin e Shpalljes:

Prof. Piero Rovigatti, Universiteti i Kietit dhe Peskarës, Fakulteti i Arkitekturës, DART
(Ambienti Rrjeti dhe Territori)

Prof. Sara Santoro, Universiteti i Parmës, Fakulteti i Gjuhëve, Departamenti i Historisë

Përgjegjës i Sitit: Piero Rovigatti | p.rovigatti@unich.it

Webmaster: Pietro Balducci | balducci.p@tiscali.it

Grafika: Maria Francesca Monteforte | mfrancescamonte@libero.it

Ftesa
Falenderimet

1. Përse një konkurs për Sheshin qendror të Durrësit
2. Përshkrimi i sitit dhe kontekstit
3. Kushtet ambientale dhe ekologjike
4. Pasuria historike dhe kulturore
5. Kushtet e përdorimit dhe karakteri identitar aktual
6. Zgjidhjet projektuese të mëparshme
7. Normativa aktuale
8. Mundësitë dhe rreziqet
9. Programi i projektit dhe analiza e sitit
10. Buxheti dhe kushtet e realizimit të programit
11. Organizimi i konkursit
12. Faza e parë. Kushtet e pjesmarrjes dhe kerkesat
13. Faza e dytë. Kushtet e pjesmarrjes dhe kerkesat
14. Proçedurat e vlerësimit dhe juria e konkursit
15. Kontrata administrative
16. Kalendari i konkursit
17. Përpunimet grafike
18. Moduli i pjesmarrjes

Ftesë për Konkursin e Sheshit Liria në Durrës

Vangjush DAKO, kryetari i Bashkisë të qytetit të Durrësit

Ideja për te mbledhur dhe seleksionuar propozimet më të mira projektuese, për rivitalizimin e sheshit qendror të qytetit tim, është një konfirmim i mëtejshëm i një aktiviteti për vlerësimin e qytetit historik dhe zones qendrore, i nisur me aprovimin e Planit Urbanistik të Integruar për Qytetin e Vjetër të Durrësit, pas shumë viteve tranzicioni dhe mungese iniziative nga ana e administratës lokale përse i perket temave të rekuperimit dhe kualitetit urban.

Kjo veprimtari ndërthuret me programet e rikualifikimit urban, të ndermarra nga Administrata lokale falë kooperimit me organizata të shumta internacionale (Bashkimi European, Banka Botërore, Kooperimi Italian per Zhvillimin, MAE) dhe kërkimet shkencore në fushën arkeologjike e urbanistike të ofruara nga Universitetet Italiane (Universiteti i Parmës, Universiteti i Bolonjës dhe kohet e fundit Universiteti i Kietit dhe Peskarës).

Kjo veprimtari përben një risi në krahasim me mënyrat e transformimit urban që kanë karakterizuar vitet e pare të tranzicionit ekonomik dhe kanë kontribuar në ndryshimin e imazhit të qytetit tim e në veçanti: zonën historike duke sjelle një pakësim të hapësirave publike e atyre të gjelbërta që vetëm kohet e fundit janë kthyer nën vëmendjen e Administratës lokale. E gjithë kjo ndodh në hipotezen e një ristabilimi të ekuilibrit ndërmjet qytetit dhe historisë që e karakterizon duke mos lene pas mundësinë e eksperimentimit të stileve të reja urbane të orientuara drej zhvillimit kulturor, të mjedisit dhe përmirësimit të jetes të qytetarëve të tij.

Riprojektimi i sheshit qendror – sheshi Liria – zemra e qytetit, prej shumë kohësh një hapësirë ku zhvillohet jeta publike, përben një rast të favorshëm për konsolidimin e një procesi të nisur dhe destinuar për kualifikimin e një organizmi të tërë urban e metropolitan. Nëpërmjet këtij aktiviteti qyteti i Durrësit kërkon të komunikojë imazhin e një qyteti në lëvizje, aktiv dhe i vëmëndshëm ndaj vlerave të së kaluarës, historisë dhe memorieve që e karakterizojne.

Falë ketyre nismave qyteti, sot, kërkon të jetë aktiv dhe plot gjallëri. Siç thotë një shprehje që kemi zgjedhur për të karakterizuar aktivitetin tonë *"Durrësi nuk ndalet kurrë!!"*

Falenderime

Ky konkurs lind nga propozimi i ekipit autor të Planit Urbanistik të Integruar për Qytetin e Vjetër të Durrësit, i aprovuar së fundi nga autoritet kompetente shqipëtarë, me 26 tetor 2007, i mirëpritur nga Administrata e qytetit tim dhe nga shumë institucione të tjera shqipëtare dhe italiane që figurojnë ne kete iniciative.

Realizimi i shpalljes dhe mbledhja e dokumenteve të ndryshme, ka qënë frut i një pune kolektive në të cilën kane dhënë ndihmën e tyre shumë studiues shqipëtarë e italianë.

Një falenderim të veçantë i dedikoj të gjithë atyre të cilët, së bashku me Bashkinë e Durrësit dhe Zyrën Projektuese për Qytetin e Vjetër të Durrësit, inagurojnë këtë aktivitet.

1. Hyrja

Përse një konkurs për sheshin qëndror të Durrësit

Zgjedhja e Sheshit qëndror të qytetit – Sheshi Liria – si një teme konkursi, është pasojë e rolit dhe rëndësisë që ky vend luan për qytetin, lidhjet që ai përcakton me ndërhyrjet e tjera të rivitalizimit urban, të ndërmara nga Administrata lokale aktuale, por mbi të gjitha për kompleksitetin e temave që ky vend nxjerr në pah.

Të gjitha temat që paraprijnë çdo lloj ndërhyrje fizike e kontemporane në qytet ballafaqohen me sheshin. Me këtë rast një projekt për sheshin Liria përbën një rast të favorshëm për të shndërruar në aksione keto tema dhe për të eksperimentuar zgjidhje të reja arkitektonike ndaj vlerave urbane që paraqet qyteti.

Shumë nga keto tema kanë paraqitur një pengësë për zhvillimin deri në ditët e sotme. Prania e një shumëllojshmërie monumentesh arkeologjike, shpesh të zbuluara gjatë ndërtimeve të reja – rasti i Termave Romake, të cilat u zbuluan gjatë ndërtimit të Pallatit të Kulturës, apo Forit Bizantin, i cilin është konsideruar deri në ditët e sotme si një motiv rreziku në vend që të konsiderohej si një motiv për vlerësimin kulturor dhe ekonomik të qytetit.

Pranisë së shumë funksioneve kolektive i është mbivendosur dhe prania e një zone me densitet të lartë rezidencial, gjithashtu rritja e trafikut urban dhe zhvillimi i një lëvizshmërie private në qytet bashkohen me levizshmerinë e këmbësoreve që karakterizon sheshin. Një tjetër temë po behet gjithmonë e më e dukshme në qytet, si rrjedhojë e zbulimit të qytetit nga ana e turizmit nacional dhe atij internacional, prania e shumë vizitorëve.

Të gjithë këtyre temave mund ti shtohet dhe roli që ky shesh ka në qytet, një hapësirë funksionale dhe simbolike për një shoqëri shumëfetare, aty ku ballafaqohen gjurmët e të kaluarës me zhvillimet e të tashmes dhe një shoqëri që varion si në stilin e jetës ahtu dhe në sjelljet individuale dhe kolektive.

Se si keto tema ndërthuren me njëra tjetrën, është një nga detyrat që pjesmarrësit e konkursit duhet ti japin një zgjidhje përveç asaj të konfigurimit të një hapësire të denjë për vlerat historike, kulturore dhe simbolike që mbart.

2. Përshkrimi i sitit dhe kontekstit. *Pak histori.*

Një përmbledhje e shpejtë historike mbi qytetin, është në gjëndie më shumë se çdo përshkrim tjetër të nxjerri në pah temat dhe motivet me interes që pritet të interpretohen nëpërmjet projektit.

Krijimi i sheshit, si krijim i një hapësire publike me zanafillë perëndimore, i vendosur në një qytet që për më tepër se pesë shekuj ka mbajtur një karakter lindor, frut i sundimit të gjatë otoman, nis në të njëjtën kohë me punimet e para urbane të promovuara nga Plani Rregullues Gjeneral i Arkitektit italian Leone Carmignani ne 1942, i cili kërkon ti japi një riorganizim të denjë urban qytetit pas tërmetit te 1926.

Sheshi i ri zë një hapësirë më të madhe seç duhet per kushtet që ofronte ajo kohë. Gjejnë vendodhje në hapësirën pas perimetrit të mureve otomane - që paraqesin një zvogëlim të mëtejshëm të mureve bizantine e atyre të periudhës romake e elenistike - në veri. Krijohet në këtë mënyre një hapësirë me dimensione të konsiderueshme, e pa përcaktuar nga ndertesa, që shumë shpejt do të bëhet pika nga e cila del rruga e re urbane, rruga Tregtare aktuale.

Në të kaluarën, sheshi paraqitej, në njërën nga të paktat harta te rilieveve italiane pas tërmetit të 1926 (L. Heuzey, H. Daumet, Archeological Mission of macedonai, Paris, 1876), si një zonë e madhe e pa ndërtuar e vendosur ndërmjet mureve otomane dhe pallatit turk i ndërtuar mbi rrenojet e fortifikimeve të mëparshme bizantine ose ndoshta klasike, një hapësirë e vendosur prapa një prej dyerve kryesore (Porta e Madhe) të një sistemi mbrojtës që harta paraqet mjaft qartë dhe në prag të shek. XIX.

Pas shëmbjes së shumë ndërtesave, e shkaktuar nga tërmeti i 1926, fillon një epoke e re transformimi për qytetin. Do të ndërtohen rrugë dhe ndërtesa të reja sipas parimeve të urbanistikës racionale, që karakterizon këtë periudhë, e cila e artikullon qytetin ne blloqe ndërtesash duke mos marrë parasysh rregullat gjeometrike që karakterizonin qytetin otoman. Përqark sheshit, të cilit Plani Rregullues i kushton një vëmëndje të veçantë, nëpërmjet projekteve sistemuese të hapësirave përreth dhe përcaktimit arkitektonik të ndërtesave më perfaqësuese që e përbejnë, si: Xhamia, Posta, zyrat e Bursës e cila nuk u realizua asnjë hereë. Lindin në këtë mënyrë ndërtesat e para publike që i japin sheshit rëndësinë e një pike qendrore për qytetin: Xhamia e cila u realizua nën projektin e Leone Carmignani, Bashkia e realizuar në fillim të viteve '30 nën projektet italiane e cila vazhdon të jëtë akoma në ditët e sotme selia e administratës lokale.

Gjatë periudhës së komunizmit ndërtohet në verilindje të sheshit Pallati i Partisë (sot i njohur si Prefektura), dhe Pallati i Kulturës në veri të sheshit. Disa nga ndërtesat ekzistuese do të pësojnë gjatë kësaj periudhe disa transformime, si për shëmbull Xhamia e cila në 1967 do te kthehet në një qendër kulturore, me këtë rast ndodh modifikimi i kupoles dhe fasadave të jashtme, pa modifikuar volumetrinë e ndërtesës. Në vitet e fundit të komunizmit ndërtesa do

të rimarë funksionin e saj të meparshëm, një vënd kulti dhe pas tërmetit të 1979 falë fondeve egjiptiane në 1993 që ndihmuan në rindërtimin e saj.

Ndërhyrjet e shumta gjatë këtyre viteve, kanë nxjerrë në pah dhe shumë gjurmë e zbulime arkeologjike. Ndër këto mund të përmëdim zbulimin e Basilikatës Paleokristiane, e cila gjëndeje poshtë themeleve të Xhamisë dhe Termave Romake të zbuluara gjatë punimeve për ndërtimin e Pallatit të Kulturës dhe Fori Bizantin akoma sot pas Pallatit të Kulturës. Në gjysmën e viteve '60, pak më larg sheshit, zbulohet Anfiteatri Romak, një nga më të medhenjtë në Ballkan, i cili tërheq vëmëndjen e arkeologëve shqiptarë dhe atyre internacional.

Tani portreti i sheshit është pak a shumë i përcaktuar. Kanë ngelur vetëm disa ndërhyrje të cilat do të ndryshojnë këtë kornizë. Rekuperimi i xhamisë dhe ndërtimi i Prefekturës, një ndërtesë e stilit racional që do të zerë vënd në lulishtet publike në fund të viteve '80 që shënojnë dhe vitet e fundit të regjimit komunist. Lokalizimi i ndërtesave publike përqark sheshit i jep atij një funksion qëndror në qytet.

Në vitet e spekulimit ndërtimor një kullë e madhe për banime dhe zyra, e vendosur në të djathtë të Bashkisë, ka çekuilibruar raportet dimensionale dhe prospektive të sheshit.

Përpara këtyre ndërhyrjeve, janë të shumta ndërtimet që ndryshojnë në mënyrë të dukshme horizontin e qytetit edhe pse shtrihen në zona në një distancë jo shumë të largët nga sheshi. E gjithë kjo panoramë bie në kundërshtim me ligjet e tutelës nacionale të cilat e njohin Durrësin si një "qytet muze" dhe qëndren e tij si një zone ku ndalohen rreptësisht ndërtimet e reja. Kohët e fundit me aprovimin e Planit Urbanistik të Integruar për Qyteti e Vjetër të Durrësit, rimerret dhe stabilizohen norma të reja, mbi tëmën e tutelës të qëndres së qytetit dhe ndalimit e ndertimeve.

Sot kemi të bëjmë me një hapësirë akoma të pa kompletuar, sidomos në pjesën lindore, e megjithatë të dendur me histori dhe monumente me rëndësi të veçantë.

Të gjitha funksionet urbane kryesore shfaqen në shesh, Bashkia, Xhamia e Madhe, Pallati i Kulturës, Prefektura dhe të gjitha monumentet historike e arkeologjike më me rëndësi janë në lidhje të drejtpërdrejtë me të, si për shembull Anfiteatri i cili arrihet nëpërmjet një shkalle në jugperëndim të sheshit e rrethohet nga muret Bizantine; Fori Bizantin i cili gjëndet prapa Pallatit të Kulturës dhe në drejtim të portit përgjatë rrugës Tregtare, Hamami antik, Kulla Veneciane dhe së fundi muret romake, ndoshta elenistike më pas bizantine dhe otomane, të cilat rrethojnë qytetin dhe sheshi Liria është zemra e tij.

Sot sheshi, një hapësirë publike e pa kompletuar, copezuar dhe me një densitet të lartë, e kundërta e një sheshi kontemporan në ditët e sotme. Është në pritje të një projekti në gjëndje të vlerësojë pasuritë historike, kulturore e arkeologjike e ti japi një imazh të ri.

3. Kushtet ambientale dhe ekologjike

Zona shtrihet në pjesën më të madhe të saj në ultesirë, me perjashtim të pjesës perëndimore e cila pëson një ngritje të lehtë që perfundon me një kuotë të lartë e cila përbën dhe pjesën kodrore të Durrësit.

Faqja kodrore përbëhet nga një bimësi diskrete e formuar nga esencat tipike të vëndeve mesdhetare. Në brendësi të tij sheshi paraqet një numer të vogël bimësie. Rruget zbukurohen me liguster, ilqe dhe esenca të tjera bimore vëndase.

Përreth Pallatit të Kulturës gjënden shumë gardhe zbukuruese me dafinë, ligustër dhe pemë të larta si ilqe. Sheshi është i ndarë në dy pjesë nga një hapësirë e gjelbërt e përbërë nga qitro, në kushte të mira mirëmbajtëse.

Në këtë kornizë, sheshi është një lidhës ekologjik ndërmjet pjesës kodrore në lindje, bimësisë që përbëjnë lagjet e qytetit duke u shtirë dëri në bregdet, i cili në të kaluarën përbëhej nga një brez pishash nga të cilat sot ka mbetur vetëm kujtimi.

4. Pasturitë historike dhe kulturore

Periudha klasike

Qyteti i Durrësit paraqet shumë dëshmi të periudhës klasike.

Ndër to më të përmendurit janë: Anfiteatri romak, pjesë të mureve otomane, veneciane e bizantine. Gjatë ndërtimeve të reja, janë të shumta pasuritë arkeologjike të gjëndura.

Sheshi paraqet një shumëllojshmëri të kësaj pasurie. Brenda perimetrit të konkursit ndodhen pasuri arkeologjike e kulturore të konsiderueshme të cilave i korrispondon se cilës një informacion përkatës.

Keto informacione, rrjedhoje e një pune të lodhshme e të pandalur e kryer nga Misioni Arkeologjik Italian i Universitetit të Parmës, janë të përmbledhura në Hartën e Rrezikut Arkeologjik të Qytetit dhe në normat specifike të tuteles dhe vlerësimit në Planin Urbanistik për Integrimin e qytetit të Vjetër të Durrësit.

Të gjitha materialtet përkatëse të këtyre strumentëve janë të disponueshëm në sitin e konkursit.

Periudha bizantine dhe otomane

Edhe kjo periudhë është e paraqitur mjaft mirë në kornizën e sheshit Liria.

Pas Pallatit të Kulturës gjëndet Fori bizantin (*Maccellum ose Markata shek. IV-VI pas.K*) i cili ka ruajtur mjaft mirë kolonat e tij, që formojnë disa harqe me një rreze prej 18 m dhe dyshemene me mermer. Kohët e fundit kjo zonë është restauruar për tu vënë në dipozicion të turistëve dhe mbi të gjitha të qytetarëve durrsakë. Rruga që rrethon këtë zonë dhe ndërtesat përreth bëjnë të mundur që të përceptohet me vështirësi.

Një element tjetër me interes arkeologjik – historik janë muret bizantine të cilat nga Pallati i Kulturës dalin pothuajse tangjent me Anfiteatrën romak, ky i fundit i përket të njëjtës periudhë kohore. Së bashku me kështjellën bizantine, që shtihet në ultësirë dukë arritur deri në kodër ku ndodhet Villa e Zogut nga e cila kanë mbetur tre nga katër kullat që e përbënin dhe që sot paraqet shenja të dukshme degradimi dhe pushtimi nga ndërtimet e paligjshme, janë ndërmarrë një sërë aksionesh rekuperimi.

Pasuritë e '900

Sheshi Liria paraqet gjurmë të rëndësishë historike e arkitektonike si rezultat i punës të arkitekteve italianë dhe atyre shqipëtarë në fillim të viteve '20.

Bashkia e realizuar në 1930, gjëndet në pjesën perëndimore të sheshit. Ndërtesa përbëhet nga një hyrje me tre harqe dhe në pjesën e sipërme të saj janë të vendosura zyrat. Ajo përfundon me një këmbanë në skajin që sheh nga rruga "Tregtare". Aktualisht në këtë ndërtesë ndodhet selia administrative e komunës së Durrësit dhe salla e këshillit. Është në diskutim e sipër një delokalizim i disa prej funksioneve të kësaj ndërtesë në mënyrë që ndërtesa të përfaqësojë një vënd ekskluzivisht për diskutime politike.

Xhamia e Madhe, aktualisht një monument kulti e cila shfaqet në të gjitha fotografitë në dhjetëvjeçarin e parë të shekullit dhe në prospektivat e sheshit të realizuara nga arkitektët italian dhe ata shqipëtarë në Planin Rregullues të Përgjithshëm të 1942. Shtrihet në këndin jug – perëndim të sheshit, në një terracë të ngritur mbi kuotën qëndrore të tij. Një pjesë e saj është rindërtuar me fonde egjiptiane në 1993, mbi strukturën e modifikuar gjatë regimit komunist (gjatë të cilit u kthye në Pallat Kulturë) dhe mbi rrenojet e shkaktuara nga tërmeti i 1979. Ndërtesa aktuale përbëhet, nga një fasadë në mermer, bazament i veshur me gurë opus incertum, hyrje të përbërë nga kolona me breza dyngjyreshe ndërsa elementët e tjerë janë të vendosur në formë shkalle deri tek kupola. Është një pikë referimi për shumë besimtarë mysliman por dhe për qytetarët e tjerë. Me dimensionet dhe vendodhjen e saj dominon jo vetëm sheshin por dhe rrugën kryesore e cila nga Hyrja Adriatikut (hyrja në port e paraqitur në Planin e '42) të çon në qëndër të sheshit.

Pallati i Kulturës (Teatri Aleksandër Moisiu)

Ndërtesa ka marrë emrin e artistit me famë botërore Aleksandër Moisiu, me origjinë durrsake, i nderuar dhe rrespektuar nga qytetarët (së fundmi edhe Universiteti i Durrësit ka marrë emrin e tij gjithashtu në brendësi të tij ndodhen disa salla të kthyera në muze plot me imazhe dhe histori në nderim të kësaj figure)

Teatri ose Pallati i Kulturës, siç janë mësuar ta quajnë qytetarët durrsakë, ndodhet në veri të sheshit Liria. Teatri është një vëndkalim jo vetëm për shumë artistë por dhe një vënd shumë i frekuentuar nga publiku. Shumë nga ambientet e tij përdoren për konferenca dhe aktivitete të tjera kolektive. Ndërtimi i tij ishte parashikuar në Planin Rregullues të Përgjithshëm të 1942 nën drejtimin e arkitektit italian Leone Carmignani ndërsa realizimi i tij u bë vetëm në 1963 në vëndin ku plani parashikonte zyrat e postës. Kantieri për realizimin e tij u bë shkas për zbulimin e Forit Bizantin në afërsi të ndërtesës. Në 2005 u krye një restaurim dhe rekuperim i ndërtesës. Sot ajo paraqitet si një ndërtesë me forma raziionaliste. Fasada e jashtme është e përbërë nga një hyrje me kolona të cilat nisin nga shkalla dhe përfundojnë me një trup me lartësi të dyfishtë të veshur me vetratë të cilat janë të ndara me shtylla të vogla çimentoje.

Prefektura

Ndërtesa është realizuar në fund të regjimit komunist dhe është e vendosur në veri – perëndim të sheshit. Stili arkitektonik me të cilin është ndërtuar është i njëjtë me atë të Pallatit të Kulturës. Aktualisht është selia e zyrave të partive politike.

5. Kushtet e përdorimit dhe karakteri identitar aktual

Situazioni ekzistues dhe destinacioni i ndërtesave

Sheshi Liria, zemra e qytetit, luan një rol social, kulturor e administrativ me rëndësi të madhe. Me formën e saj drejtkëndëshe përmbledh një sërë ndërtesash institucionale, kulturore dhe banuese, njëkohësisht në këtë kontekst bëjnë pjesë dhe elementë arkeologjik me rëndësi të madhe.

Një përshkrim historik i detajuar i këtyre elementëve është bërë në paragrafin e mëparshëm. Në këtë paragraf bëhet një përmbledhje në formë inventari për të përcaktuar jo vetëm rëndësinë por për ti dhënë dhe një mundësi frekuentimi nga ana e turistëve.

Ndërtesa institucionale dhe kulturore

Bashkia (realizuar në 1930)

Xhamia e Madhe (restauruar në 1993)

Prefektura

Pallati i Kulturës "Aleksander Moisiu" (realizuar në 1963)

Zonat Arkeologjike

Anfiteatri

Pjesë e mureve të periudhës Bizantine

Xhamia e Madhe

Fori Bizantin

Degradimi dhe proceset e transformimit


Sheshi në tërësinë e tij nuk paraqet shenja të mëdha degradimi, përveç në disa pjesë të veçanta të perimetrit të tij. Në përgjithësi hapësira publike paraqet kushte normale të mirmbajtura si përsa i përket rrugëve automobilistike, të këmbësorëve dhe lulishtet. Kushte normale dhe të pranueshme paraqet dhe ndriçimi i sheshit në raport me pjesët e tjera publike.

Bordi perëndimor i sheshit, përballë Xhamisë dhe Prefekturës, paraqet zona të gjëlbërta në kushte të mira, që ndoshta duhet vetëm të rivizatohen në një mënyrë më të mirë për tu shfrytëzuar nga publiku. E kundërt është gjëndia që paraqet bordi verior i sheshit, prapa Pallatit të Kulturës dhe përreth tij deri në zonën arkeologjike të Forit bizantin dhe Termave Romake. Në këtë pjesë cilësia e zonës arkeologjike dhe vlerat e saj janë të dëmtuara si nga mungesa e mirëmbajtjes ashtu dhe ndërtimeve e aktiviteteve të shumta (bar, restaurante, tenda) të cilat tentojnë të përhapen dhe të ndrshojnë në mënyrë të dukshme imazhin e kësaj zone. Në mënyrë analoge paraqitet dhe bordi veri-lindor i sheshit. Në këtë pjesë ndodhen shumë ndërtesa të ulta, në kushta mjaft të këqia sanitare dhe banuese, gjithashtu mungon një limit ndërtimor, i paraqitur me lulishte ose ndërtesa. Në këtë pjesë të sheshit Plani i 1942 parashikonte një ndërtesë të gjatë me porta e cila do të shërbente për të mbyllur hapësirën e tij. Plani Urbanistik i Integruar për Qytetin e Vjetër të Durrësit përveç se nëpërmjet normave ndalon rreptësisht ndërtimet në këtë pjesë të qytetit, bën përcaktimin e këtij limiti një nga operacionet, ndoshta, më komplekse në të cilën vëmëndia e pjesëmarrësëve të konkursit kërkohet të jëtë më krijuese.

Vëmëndja shtrihet dhe në ndërhyrjet që i përkasin zonës që shtrihet ndërmjet Xhamisë së Madhe dhe mureve bizantine të cilat ngjiten drejt Kështjellës. Vihet re se si kjo zonë, në të kaluarën një park i cili shtrihej deri tek Vila e Zogut, sot zihet nga ndërtesa dhe aktivitete abuzive. Një reflektim për një ide të parë (faza e parë e konkursit) mund të jetë pikërisht përtëritja e parkut (një masë kjo e marë dhe nga Plani për Zonën Qendrore) dhe shëmbia e ndërtesave dhe aktiviteteve abuzive.

Popullsia dhe përdorimet aktuale. Përceptimi i hapësirës publike nga banorët.

Në skemën më poshtë janë të specifikuar rrugët urbane kryesore dhe dytësore të cilat përshkojnë sheshin. Vihet re se si rrugët kryesore preferojnë bordin perëndimor të sheshit. Kjo preferencë derivon nga dy faktorë: në këtë pjesë janë prezent shërbimet kryesore publike: Bashkia, Xhamia, Prefektura dhe njëkohësisht në këtë pjesë ndodhet bulevardi kryesor rruga "Tregtare" e cila ka rolin jo vetëm të një shëtitoreje, në orë të caktuara të ditës, por njëkohësisht është rruga që mbledh dhe më pas shpërndan trafikun në pjesë të ndryshme të qytetit. E kundërta, rrugët dytësore të cilat përshkojnë ndërtesat dhe lidhin referimet dytësore, si: banjot, lulishten dhe shetitoren, shatërvanin dhe bibliotekën.



Një sugjerim tjetër, i cili derivon nga hetimet në terren, është që të meren në konsideratë jo vetëm fuksi i trafikut (kembësor dhe ai i mjeteve) por dhe hijëzimi dhe vënde e ndryshme që aktualisht ndodhen në shesh dhe përbëjnë një vënd identitar për të.

6. Zgjidhjet projektuese të mëparshme

Hapësira e sheshit Liria, e pa kompletuar dhe e pa përfunduar, prezantohet me një repertor të gjërë zgjidhjesh projektuese të tentuara në vitet e para të ndërtimit të tij.

Sheshi Liria përcaktohet në Planin e 1942, pas tërmetit të 1926. Planet përkatëse mund të konsultohen në sitin e internetit të sheshit, të cilët ndjekin këtë rrjedhë kronologjike.

- a. Plani i 1942
- b. Propozimet projektuese të prezantuara në 1963
- c. Propozimi projektues i prezantuar 1963
- d. Propozimet e prezantuara nga Konkursi për zonën qendrore
- e. Propozimet e prezantuara nga Plani për Zonën qendrore në 2007
- f. Projekti për restaurimin e pallatit të Kulturës në 2005

7. Normativa aktuale

Në sitin e internetit janë vënë në dispozicion kartat e Planit të Zonës Qëndrore, të cilat japin informacione për sheshin Liria. Propozimet projektuese nga ana e pjesëmarrësve të konkursit duhet ti përmbahen rreptësisht dispozitivave normative të caktuara në Plan.

Lista e këtyre kartave është e mëposhtmia:

1. Situacioni ekzistues (pjesë e kartës 2 të Planit Urbanistik të Integruar për Qytetin e Vjetër të Durrësit; shkalla 1:2000)
Indikime strukturale (pjesë e kartës 3 të Planit)
2. Struktura e propozuar (pjesë e kartës 3 të Planit Urbanistik të Integruar për Qytetin e Vjetër të Durrësit; shkalla 1:2000)
3. Standartet urbanistike (pjesë e kartës 5 të Planit)
Hapësira dhe shërbime publike, Standartet funksionale të projektit (pjesë e kartës 5 të Planit Urbanistik të Integruar për Qytetin e Vjetër të Durrësit; shkalla 1:2000)
4. Sistemi i tutelës arkeologjike dhe monumentale (pjesë e kartës 6 të Planit)
Sistemi i tutelës dhe vlerësimit (pjesë e kartës 6 të Planit Urbanistik të Integruar për Qytetin e Vjetër të Durrësit; shkalla 1:2000)
5. Rrugë dhe shërbime (pjesë e kartës 7 të Planit)
Sistemi infrastrukturor dhe i lëvizshmërisë të qëndrueshme (pjesë e kartës 7 të Planit Urbanistik të Integruar për Qytetin e Vjetër të Durrësit; shkalla 1:2000)
6. Regjimi i Trasformimit. Ndërhyrjet prioritare. (pjesë e kartës 9 të Planit) Regjimi i Trasformimit. Ndërhyrjet prioritare *mbi ndërtesat dhe hapësirat publike.* (pjesë e kartës 9 të Planit Urbanistik të Integruar për Qytetin e Vjetër të Durrësit; shkalla 1:2000)

7. Itinerarët turistik – kulturor (pjesë e kartës 10 të Planit)
Itinerarët historik – turistik. (pjesë e kartës 10 të Planit Urbanistik të Integruar për Qytetin e Vjetër të Durrësit; shkalla 1:2000)

8. Mundësitë dhe rreziqet

Projektet e konkursit janë të detyruar ti përmbahen këtyre temave.

a. Arkeologjia dhe pasuritë kulturore

Kerkoheq që ti jepet një vlerësim i duhur pasurisë arkeologjike që karakterizon sheshin dhe hapësirat përreth tij në periudha të ndryshme historike, duke iu referuar dhe normave aktuale të tuteles dhe vlerësimit, nacionale dhe atyre të specifikuara nga Plani për Zonën Qëndrore.

b. Hapësirat e gjelbërta dhe vazhdimësia ekologjike

Projekti i propozuar duhet të ruajë hapësirat e gjelbërta ekzistuese të sheshit dhe duhet të synojë rritjen e këtre hapësirave për të siguruar më shumë gjelbërim në dispozicion të qytetarëve dhe një vazhdimësi ekologjike me elementët natyror të përmëndur në paragrafët e mëparshëm.

Pjesmarrësit duhet të rrespektojnë cilësinë natyrore dhe pamjen e sheshit duke propozuar mënyra të reja dhe risi pa ndryshuar rrënjësisht praninë e esenzave bimore dhe hapësirave të gjelbërta. Duhet të propozohet ruajtja e çdo peme që mendohet të eliminohet ose të zëvendësohet.

c. Ngjarjet publike dhe manifestimet

Çdo sistemim i propozuar duhet të synojë rritjen dhe përmisimin e hapësirave të sheshit për përdorime me rastin e manifestimeve politike, ngjarjeve muzikore, artistike e teatrale. Duhet gjithashtu të ruhet karakteri kryesor i sheshit, si një hapësirë kryesore publike dhe multifunksionale në qytet. Në këtë prespektivë duhet të fuqizohen të gjitha lidhjet që kjo hapësirë vendos me pjesët e tjera të qyteti.

d. Integrimi dhe rikonsiderimi i elementëve ndërtimor (Xhamia, Pallati i Kulturës, Bashkia, Biblioteka, etj)

Propozimi duhet të këtë parasysh funksionet dhe rëndësinë e këtyre ndërtesave dhe gjithashtu hapësirat në shërbim të tyre (parkinge, lidhjet me transportin publik dhe atë të këmbësorëve e të rrjetit çiklist, etj) duke iu referuar normave aktuale.

e. Lëvizshmëria publike dhe private.

Çdo propozim duhet të mbajë parasysh funksionimin e sheshit duke u bazuar në lëvizshmërinë publike dhe atë private, duke i kushtuar një vëmëndje të veçantë lëvizshmërisë të këmbësorëve dhe asaj çikliste, bazuar dhe në parashikimet e Planit për Zonën Qëndrore të qytetit. Nuk duhet të parashikohen parkinge të nëndheshme. Parkinget duhet të jënë në funksion të publikut ose parkinge speciale me pagesë. Një vëmëndje të veçantë duhet ti kushtohet arritjes së sheshit dhe nga persona me aftësi të kufizuar.

f. Qëndrueshmëria ekologjike, natyrore e sociale e projektit

Duhet të kihet parasysh të gjitha ndërhyrjet të cilat prodhojnë impakte negative mbi ambientin (shëmbjet, gërmimet, materialet dhe teknikat e përdorura, konsumet energjitike që nevojiten, etj). Në bazë të këtyre konsideratave priten ndërhyrje të cilat janë në gjendje të përdorin teknologjitë e fundit për uljen e shpërdorimeve energjitike dhe impakteve të tjera negative të prodhuara mbi ambientin.

9. Programi i projektit dhe analiza e sitit

Për të realizuar materialet e konkursit që shërbejnë për fazën e dytë, do të vihen në dispozicion të pjesmarrësve informacione, kartografi në lidhje me:

Përdorimet e terrenit

Pronat publike

Perkinget ekzistuese

Trasporti publik ekzistues dhe ai i parashikuar

Plani kuotues i sheshit

Materialet dhe tipologjitë mbizotëruese

Gjelbërimi

Infrastrukturat nëntoksore (rrjeti i ujrave nëntoksore, rrjeti elektrik publik dhe ai privat; rrjeti i telekomunikacionit, gazit, internet servis, etj)

Orenditë publike

Mbledhja e plehrave

Monumentet dhe vendet me identitet

Sigurimi publik

Shëmbie dhe ndërtime të reja

Në lidhje me fazën e parë pjesmërrësit mund të përdorin materialet, informacionet dhe përshkrimet të paraqitura në shpallje të cilat mund të konsultohen dhe në sitin zyrtar të internetit në dispozicion të konkursit.

10. Buxheti dhe kushtet e Realizimit të programit

Bashkia e Durrësit ka parashikuar një investim kompleksiv për realizimin e veprave publike (sistemimet arkitektonike dhe të hapësirave publike) prej 5 milion euro. Zonat publike në të cilat do të kryhen ndërhyrjet kanë një sipërfaqe prej 25.000 m². Kjo sipërfaqe i korrispondon gjysmës së sipërfaqes të sheshit Skënderbej në Tiranë, për të cilin Bashkia e Tiranës, me rastin e konkursit internacional, ka parashikuar një investim prej 10 milion euro.

Në fazën e parë të konkursit pjesmërrësit mund të paraqisin një vlerësim paraprak, të shprehur në mondhe, të projektit në të cilin parashikohet pjesmarrja e subjekteve privatë për financimin e veprave publike të parashikuara. Është e mundur dhe një shkëmbim ndërmjt pronave publike dhe atyre private për të rritur dhe konsoliduar pasuritë publike dhe sidomos në vantazh të zonave me interes arkeologjik, historik, kulturor e natyror.

Në fazën e dytë të konkursit, grupet e seleksionuara, duhet të paraqesin nje vlerësim të detajuar të kostove për realizimin e veprave të parashikuara, si private ashtu dhe atyre publike, gjithashtu dhe kostot e nevojshme për të blerë toka për realizimin e veprave publike.

11. Organizimi i konkursit

Organizimi i konkursit internacional përbëhet nga:

1. një komitet shkencor për përpilimin e shpalljes dhe kërkimin paraprak të një projekti
2. një juri e përbërë nga ekspertë internacional të dëgjuar në fushën e urbanistikës, projektimit e kompozimit arkitektonik, fatibilitetit ekonomik e financiar të projektit, të arkeologjis, restaurimit tuteles e valorizimit të pasurive kulturore dhe ekologjis urbane;
3. një komitet sponcorizues dhe promovues i iniciativës i përbërë nga përfaqësues të instituteve bankare sipërmarrësit lokalë të cilët impenjohen për të dhënë kontributin e tyre në fazat e ndryshme të konkursit nëpërmjet mikpritjes dhe asistencës të grupeve të ftuara në fazën e dytë të konkursit, pjesmarrjen e qytetarëve në ndërtimin dhe propozimin e ideve projekt, në përhapjen dhe publikimin e rezultateve (publikimet në shtyp, siti ëeb i konkursit, përhapja nëpërmjet mediave nacionale dhe internacionale).

Konkursi zhvillohet në qytetin e Durrësit. Përgjeggjës i proçedurës është nënkryetari i Bashkisë të Durrësit, inxh. Adrian Çela të cilit i bashkangjitet ark. Ina Xhakoni, përgjeggjëse e Zyrës së Urbanistikës Durrës. Sekretaria e konkursit mbështetet në bashkpunimin e INARK, në strukturat dhe ekspertët e tij.

12. Faza e parë. Kushtet e pjesmarrjes dhe kërkesat.

Konkursi organizohet në dy faza.

Në fazën e parë pjesmarrësit i nënshtrohen vlerësimit të një jurie, e përbërë nga ekspertë të ndryshëm, nëpërmjet paraqitjes së një projekti preliminar dhe C.V. personale ose të grupit. Qëllimi është jo vetëm paraqitja e ideve projekt fillestare për sheshin por dhe kualifikimi dhe eksperiencat në këtë fushë.

Juria në fazën e parë, pas shqyrtimit të projekteve dhe C.V., do të zgjedhi vetëm 5 grupe, të cilët kalojnë automatikisht në fazën e dytë.

Grupet e fazes së dytë të konkursit do të marin, në përfundim të kësaj faze, një shpërblim prej 10.000,00 euro secili ndërsa projekti fitues do të shpërblehet me një shumë prej 200.000,00 euro.

Pjesmarrja në fazën e parë është e lirë dhe falas. Mund të marrin pjesë si profesionist ahtu dhe grupe të përbërë nga figura kompetente.

Në fazën e parë të konkursit çdo grup pjesmarrës duhet të dorëzojë (brënda datës 25 shtator) këto dokumenta dhe materiale:

1. një dokument në të cilin specifikohen emrat përbërës të grupit, kryetari i grupit dhe kualifikimi i secilit përbërës me Urdhërin përkatës në të cilin bën pjesë;
2. një raport projekti në formatin A4, në të cilin specifikohen objektivat kryesorë, strategjitë dhe arsione që mendohen të ndërmerren si dhe një vlerësim paraprak i kostove komplekse të ndërhyrjeve të propozuara;
3. n. 3 karta në formatin A3, kompozimi është i lirë dhe duhet të paraqesin në mënyrë të qartë idetë e para projektuese të propozuara. Mund të përdoren në këtë fazë, më qëllim demonstrues, skiza, foto, diagrame, skema, nuk kërkohen në këtë fazë, vizatime të detajuara në planimetri për zonën e projektit. Pjesmarrësit duhet ti përgjigjen këtyre pyetjeve: *përse* është e nevojshme një ndërhyrje në sheshin Liria dhe hapësirat e saj publike, *si* mund të realizohet kjo ndërhyrje, *çfarë* mund të realizohet për rivitalizimin e sheshit dhe qëndrës urbane të qytetit.

Kushtet për mospjesmarrje në konkurs

Nuk mund të marrin pjesë në konkurs të gjithë ata që kanë, lidhje familiare deri në gradën e tretë dhe ata që kanë lidhje punësie me pjestarët e jurisë, nëpunësit e Bashkisë të Durrësit apo ekspertët të cilët kanë punuar për përpilimin e shpalljes.

13. Faza e dytë. Kushtet e pjesmarrjes dhe kërkesat.

Grupet e klasifikuara për fazën e dytë duhet të paraqesin një projekt përfundimtar, në shkallë dhe të detajuar të bazuar në idetë e fazës së parë.

Ky projekt duhet të zhvillohet në jo më pak se 5 karta në formatin A0, nje plastik (në shkallë jo më pak se 1:500), një raport të cilit duhet ti bashkangjiten vlerësimet përkatëse të kostove komplekse të projektit. Grupet e klasifikuara në fazën e dytë duhet të deklarojnë, në momentin e pranimit në këtë fazë, këto figura profesionale:

1. arkitekt
2. arkitekt pejsazhi
3. arkeolog
4. inxhinier
5. ekspertë në vlerësimet ekonomike të projekteve
6. artistë (artet vizive dhe të komunikimit)

14. Proçedura e vlerësimit dhe juria e konkursit

Kriteret e vlerësimit të fazës së parë dhe të dytë.

Juria do të zgjedhë projektet duke u bazuar në cilësinë, risitë dhe përputhshmërinë me temat e konkursit të përcaktuara në pikët 8.

Juria e fazës së parë dhe të dytë do të përbëhet nga ekspertë me famë internationale që i përkasin sektorëve të ndryshëm në lidhje me temat e shpalljes.

Juria paraprihet nga kryetari i Bashkisë të Durrësit, dhe më pas pjestarë të tjerë si: përfaqësues të Ministrisë të Punëve publike, Instituti kombëtar i Monumenteve dhe

Arkeologjisë të Republikës të Shqipërisë dhe përfaqësues të Universiteteve Shqipëtare.

INARK do të ketë rolin e një drejtuesi dhe garanti për cilësinë dhe rezultatet e punës të jurisë.

Rezultatet e konkursit të të dyja fazave do të publikohen në sitin zyrtar të Bashkisë të Durrësit dhe atë të konkursit.

15. Kontrata administrative.

Kushtet e kontratës administrative për grupin fitues të fazës së dytë, do të bëhet duke u bazuar në ligjet aktuale dhe do të komunikohet në sitin eeb të konkursit përpara fillimit të fazës së dytë të konkursit.

Bashkia e Durrësit, enti kryesor i shpalljes, do të besojë punimet grupit fitues nëpërmjet procedurave normale të garës.

Administrata duke u bazuar në ndërlikimet teknike projektuese dhe risitë e propozuara nga projekti, ngarkon grupin autor të projektit në drejtimin e punime.

16. Kalendari i konkursit.

2 korrik 2008:

konferenca e prezantimit të iniciativës në Torino (XXIII UIA World Congress of Architecture) dhe hapja e regjistrimeve të fazës së parë të konkursit– prezantimi i sitit web, CD rom dhe Video

2 korrik – 21 korrik 2008:

azhurnimi i sitit web të konkursit me materiale grafike dhe tekste

muajt korrik dhe gusht 2008:

vizita nën guidë, në vëndin e konkursit– seminare dëgjimi dhe pjesmarrje për projektin

25 shtator 2008:

përfundimi i dorëzimit të materialeve të fazës së parë (tre karta në formatin A3, raporti i projektit preliminar, kurrikulumit të grupit projektues). Dorëzimi i materialit përbën automatikisht aktin e regjistrimit në konkurs. Modalitetet e dorëzimit të materialeve janë të specifikuar në shpalljen zyrtare të konkursit, e disponueshme në sitin web të konkursit, në adresën www.iliriasquarecompetition.org

27 shtator 2008 (Forumi i qyteteve të Adriatikut dhe Jonit):

Shikimi i projekteve të fazës së parë. Shpallja e rezultateve të fazës së parë të konkursit. Konferenca dhe prezantimi i propozimeve të shpallura në fazën e parë Nisja e fazës së dytë të konkursit

27 shtator – 28 tetor 2008

Pjesmarrja dhe diskutimi në publik i propozimeve të zgjedhura (forumi telematik, pyetsor, forumi tematik me subjektet e interesuara dhe qytetarët)

28 dhjetor 2008

perfundimi i dorëzimit të materialeve të fazës së dytë të konkursit. Modalitetet e dorëzimit të materialeve janë të specifikuar në shpalljen zyrtare të konkursit, e disponueshme në sitin web të konkursit, në adresën www.iliriasquarecompetition.org

28 janar 2008

Shpallja e projektit fitues

17. Përpunimet grafike

1. Kartografia bazë

- 1.1 Fotot ajrore të kontekstit në studim, 2007
- 1.2 Inkuadrimi i zonës qendrore, formati A3, shkalla 1:5.000
- 1.3 Inkuadrimi i sektorit urban, formati A3, shkalla 1:2.000
- 1.4 Sheshi Liria dhe hapësirat përreth, formati A3, shkalla 1:1.000

2. Përpunime grafike nga fotot ajrore të azhornuara

- 2.1 Sheshi Liria dhe hapësirat përreth, situazioni ekzistues, plani i kuotuar, A3 shkalla 1:1.000
- 2.2 Sheshi Liria , plani i kuotuar, situazioni ekzistues, A3 shkalla 1:500

3. Fotot e rilievit

- 3.3 Foto e kompozuar e sheshit pjesa Veri, formati A3
- 3.4 Foto e kompozuar e sheshit pjesa Jug, formati A3
- 3.5 Foto e kompozuar e sheshit pjesa Perendim, formati A3
- 3.6 Foto e kompozuar e sheshit pjesa Lindje, formati A3

4. Pjesë të planit (Plani i zonës qendrore të Durrësit (PACD), KReTSh, 28 tetor 2008

- 4.1 Pjesë e kartës dhe azhornimi i situacionit ekzistues dhe të drejtave (karta 2 PACD) (legjenda)
- 4.2 Rikonstruimi i situacionit ekzistues dhe të drejtave (pjesë e kartës 2 të Planit)
- 4.3 udhëzime strukturale (pjesë e kartës 3 të Planit)
- 4.4 Standartet urbanistike (pjesë e kartës 5 të Planit)
- 4.5 Sistemi i tutelës arkeologjike dhe monumentale(pjesë e kartës 6 të Planit)
- 4.6 Rrugë dhe shërbime (pjesë e kartës 7 të Planit)
- 4.7 Regjimi i transformimit. Ndërhyrjet prioritare (pjesë e kartës 9 të Planit)
- 4.8 Itinerare turistike – kulturore (pjesë e kartës 10 të Planit)

5. Kartografitë e konkursit

- 5.1 Identifikimi i zonës së konkursit, A3 shkalla 1:1.000
- 5.2 Karta e pronësive publike, A3 shkalla 1:1.000
- 5.3 Skema drejtuese të projektit, A3 shkalla 1:1.000

6. Kartografitë historike

18. Moduli i pjesëmarrjes në fazën e parë.

Pjesëmarrësit në fazën e parë duhet të paraqesin dokumentacionin përkatës në një zarf të mbyllur, i cili duhet të njihet me moton identifikues të grupit dhe duhet të përmbajë këto materiale:

- a) Raporti i projektit, maksimumi 6 fletë të shkruajtura ose me skica e vizatime indikative;
- b) n. 3 karta në A3, të specifikuar në pikën 12;
- c) një CD që përmban ekskluzivisht materialet në pikën a) dhe b) dhe moton e projektit pa asnjë indikim tjetër, ndëshkim përjashtimi nga konkursi;
- d) një zarf i mbyllur me moton identifikues të grupit i cili përmban një deklaratë përsa i përket:
 - motoja e projektit;
 - data e realizimit të projektit (brënda 25 shtator 2008);
 - emri i kryetarit të grupit;
 - pjestarët e grupit me të dhënat përkatëse anagrafike të secilit, profesioni dhe adresa e-mailit.

Së bashku me këtë dokument duhet të jëtë në të njejtin zarf CV e kryetarit të grupit po të jëtë e nevojshme dhe CV e pjestarëve të tjetër të grupit. Në këtë dokument duhet gjithashtu të specifikohen veprat e parashikuara nga projekti me përshkrime të shkurtra dhe ilustrime me foto ose vizatime dhe kosto e tyre.

Ky dokument duhet të dorëzohet brënda orës 24,00 të 25 shtator 2008 në këtë adresë:

Inxh. Adrian Çela

Bashkia e Durrësit,
Durrës, Shqipëri

Sipër zarfit në të majtë duhet të jetë shkruajtur:

ILIRIA SQUARE COMPETITION

Sekretaria e Konkursit:

RECEPTION OFFICE OF THE CONTEST

INA XHAKONI, URBANISTIC OFFICE MUNICIPALITY OF DURAZZO

E – MAIL adrian.cela@durres.gov.al

FOR PHONE CONTACT INFORMATION 00355 2 224800, MOBILE PHONE 00355 692049383